



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Prilbena Më/Dana 04-05-2022 vit/gj			
Nr./ organit Org.broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-110/05	471		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 18 të Ligjit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Nr.06/L-092, nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.04.2022, merr këtë:

VENDIM

për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të ankandit publik për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komisioni për shqyrtimin e ankesave të ankandit publik për dhënien e pronës së komunës afatshkurtër dhe afatgjatë në Komunën e Vitisë.

Komisioni propozohet pre 5 anëtarëve, dy nga ekzekutivi, dy kuvendi i komunës dhe një nga shoqëria civile dhe atë:

- Remzi Januzi, anëtar i komisionit, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës;
- Arian Alidema, anëtar i komisionit, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës;
- Sokol Hyseni, përfaqësues i Kuvendit të Komunës (subjekti LDK)
- Nexhat Halili, përfaqësues i Kuvendit të Komunës (subjekti LVV)
- Florim Brahimi, përfaqësues i sektorit jo qeveritar.

Neni 2

Me këtë vendim, detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019), shqyrtimi i të gjitha ankesave të paraqitura, kthimi i përgjigjeve brenda afatit ligjor dhe raportimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen kryetari i Komunës dhe gjitha drejtoritë e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit, drejtorive;
2. Anëtarëve të komisionit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI
Bekim Azizi

